



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 286/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.05.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktues mbi skualifikimin e shoqërisë “Albavia” sh.p.k. nga procedura e konkurrimit me objekt: *“Dhënie me koncesion për ndërtimin e hidrocentralit “Ura e Tamarës”, zhvilluar më datë 26.01.2015 nga autoriteti kontraktues, Ministria e Energjisë dhe Industrisë.*

Ankimues: “Albavia” sh.p.k.
Rruga *“Sulejman Delvina”*, Pallati Fati, Kati 8, Apartamenti 19, Tiranë.

Autoriteti Kontraktues: Ministria e Energjisë dhe Industrisë
Bulevardi *“Dëshmorët e Kombit”*, Nr. 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 *“Për Konçensionet”* i ndryshuar me Ligjin nr. 125/2013 *“Për Koncesionet dhe partneritetin publik privat”*, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 *“Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e shqyrtimit të ankesave ndaj procedurave të koncesionit apo të vendimeve për përjashtim nga këto procedura”, dhe “Për një ndryshim në vendimin nr. 27”, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së konçensioneve”, VKM nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;**

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N: I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë konkurrimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktues dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e konkurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktues dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.11.2014 është publikuar në portalin elektronik të prokurimeve, procedura e konkurimit me objekt: “*Dhënie me koncesion për ndërtimin e hidrocentralit "Ura e Tamarës"*”, zhvilluar më datë 26.01.2015 nga autoriteti kontraktues, Ministria e Energjisë dhe Industrisë.

II.2. Në datën 26.01.2015, autoriteti kontraktues ka zhvilluar procedurën e mësipërme të konkurimit.

II.4. Në datën 06.03.2015 autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 2913/17 prot., ka njoftuar operatorin ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k., nëpërmjet “Formularit për ofertuesin e skualifikuar”, duke i komunikuar skualifikimin e tij nga kjo procedurë konkurrimi.

II.5. Në datën 12.03.2015 operatori ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktues, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

II.6. Në datën 17.03.2015 autoriteti kontraktues, me anë të shkresës nr. 2913/21 prot., i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën e tij.

II.7. Në datën 25.03.2015 operatori ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kërkuar kualifikimin e tij.

II.8. Në datën 31.03.2015 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e konkurrimit të sipërcituar, ku ndër të tjera vë në dijeni KPP-në se: *“Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka ndërmarrë dhe procedurën e dhënies me koncesion të hidrocentralit “Brojë” dhe gjatë përcaktimit të objektit të koncesionit lidhur me vendndodhjen e tij, është konstatuar se ka mbivendosje kuotash me objektin e procedurës konkurruese “Ura e Tamarës”, pasi segmenti i rrjedhës ujore në zonën e Urës së Tamarës (bëhet fjalë për një objekt ekzistues, urë) të kësaj procedure konkurruese, është në të njëjtin pellg ujëmbledhës, atë të lunit të Cemit e degët e tij. ...*

Duke qenë se, kuota në kufi të dy objekteve (Ura e Tamarës, tashmë në procedurë dhe Broje) është e pa qartësuar si dhe në kushtet kur vazhdimi i mëtejshëm i të dy procedurave në fjalë do ta bënte të pamundur dhe jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues, për finalizimin me Kontrata Koncesionare përkatëse, Autoriteti Kontraktues MEI, në bazë të nenit 24 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ka vendosur anulimin e procedurës tashmë në vlerësim të HC “Ura e Tamarës” si dhe përgatitjen e DSK të Brojes, pas saktësimit të kuotës kufitare midis këtyre dy objekteve.”

II.9. Në datën 28.04.2015 Komisioni i Prokurimit Publik zhvilloi një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të subjektit ankimues “Albavia” sh.p.k. dhe përfaqësuesve të autoritetit kontraktues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankimin operatorit ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi”, pika 1/a, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm: a) për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik.”*

III.1.2. Në seancën dëgjimore të zhvilluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në prani të përfaqësuesve të subjektit ankimues “Albavia” sh.p.k. dhe të autoritetit kontraktues, ky i fundit shprehet se, informacioni i dhënë në Dokumentat e Koncesionit është i paqartë pasi, në vetvetë ka mospërputhje të dhënash, duke i vendosur operatorët ekonomikë pjesëmarrës në pozicion të pabarabartë, gjë që konstatohet edhe në ofertat e dorëzuara prej tyre, të cilat janë përgatitur duke u bazuar në të dhëna të ndryshme si rrjedhojë e këtij informacioni të pasaktë, gjë që konstatohet edhe nga KPP.

Komisioni, vëren pozitën specifike të autoritetit kontraktues si subjekt drejtpërdrejt përfitues i kësaj procedure konkurrimi dhe përgjegjës për monitorimin e zbatimit me sukses të kontratës sipas legjislacionit në fuqi. Referuar informacionit të dorëzuar prej autoritetit kontraktues, KPP gjykon se, vendimi mbi anulimin e kësaj procedure konkurrimi nga Ministria e Energjisë dhe Industrisë është i bazuar dhe i justifikuar pasi, është i qartë fakti që, duke qenë se kuota në kufi të dy objekteve, HEC “Ura e Tamarës” në proces dhe HEC “Broje” i parashikuar për një moment të dytë, është e pa qartësuar dhe vazhdimi i mëtejshëm i të dy procedurave në fjalë do të dilte jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues, duke bërë të pamundur finalizimin me lidhjen e Kontratave Koncesionare përkatëse.

Sa më sipër, autoriteti kontraktues lejohet të vazhdojë me anulimin e kësaj procedure konkurrimi.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albavia” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar sa më sipër kjo procedurë konkurrimi do të anulohet nga autoriteti kontraktues.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të lejohet autoritetin kontraktues të vazhdojë me anulimin e procedurës së konkurrimit “*Dhënie me koncesion për ndërtimin e hidrocentralit Ura e Tamarës*”, zhvilluar më datë 26.01.2015 nga autoriteti kontraktues, Ministria e Energjisë dhe Industrisë.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatën përkatëse për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 497 Protokolli; Datë 25.03.2015

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri